REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 715/20
Datë/Datum. 29.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMI
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.715/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Goran Milenković - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues dhe Z. Blerim Dina – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "IT Market" sh.p.k – Prishtinë, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit me titull: "Vendosja e kamerave dhe mirëmbajtja e tyre në Qytetin e Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-20-2166-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Prizrenit, me datën: 28.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik OE "IT Market" sh.p.k – Prishtinë, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit me titull : "Vendosja e kamerave dhe mirëmbajtja e tyre në Qytetin e Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-20-2166-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Prizrenit.

II. **ANULOHET**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull "Vendosja e kamerave dhe mirëmbajtja e tyre në Qytetin e Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-20-2166-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Prizrenit, dhe lënda kthehet në **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: OE "IT Market" sh.p.k– Prishtinë , aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës .

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik "IT Market" sh.p.k – Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 25.09.2020 me nr. 715/20, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit me titull "Vendosja e kamerave dhe mirëmbajtja e tyre në Qytetin e Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-20-2166-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Prizrenit duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin:7,59,64,66 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 28.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt:06.10.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:
Pretendimet ankimore të OE ankues kanë të bëjnë me disa nga arsyet e eliminimit të dhënë nga AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, të dërguar me datë 08.09.2020.

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr.1
Lidhur me projektet e natyrës së kontratës, AK ka konstatuar se projektet e OE nuk janë të natyrës së kontratës. Bazuar në listën e kontratave të paraqitura nga OE, kontratat janë të natyrës së njëjtë dhe janë brenda kodit të klasifikimit të fjalorit të përgjithshëm të prokurimit (FPP) që ka kërkuar AK. Ky kod në njoftimin për kontratë është 50000000-5 dhe si fushëveprim ka "Pajisjet për meremetim, mirëmbajtje dhe Instalim", gjë që nga lista e projekteve të dorëzuara nga OE, bazuar në kontrata, referenca dhe përshkrimet tjera, ky aktivitet i prokurimit ka natyrën e njëjtë.

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr.2

AK ka konstatuar se nuk janë përcaktuar personat me ndonjë vendim apo marrëveshje të veçantë për pozitat: Menaxher i projektit dhe Ekspert i rrjetave kompjuterike.

Lidhur me ndonjë marrëveshje apo vendim të veçantë për Menaxherin e Projektit dhe Ekspertin e rrjetave kompjuterike, në njoftimin për kontratë nuk është kërkuar ndonjë dëshmi e tillë dokumentare specifike. Prandaj, AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 59 dhe 72 të LPP-së dhe pikën 39.8 të Rregullës së Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, ku AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit", nëse CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara dhe AK nuk mund të vendos.

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr.3

AK ka konstatuar se për pesë teknik të implementimit – Mungojnë CV-të për të gjithë tekniket e implementimit kopjet e diplomave dhe janë paraqitur vetëm katër kontrata pune për kohë të pacaktuar. Lidhur me stafin OE ka paraqitur CV-të dhe dokumente përcjellëse të 10 anëtarëve të stafit. Prandaj, AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 59 dhe 72 të LPP-së dhe Rregullës së Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, ku AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit", nëse CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara dhe AK nuk mund të vendos. Pra, meqenëse nuk ka qenë e qartë për komisionin e vlerësimit të AK-së, funksioni i secilit nga stafi i paraqitur në ofertën e OE, dhe nga AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk janë kërkuar dëshmi dokumentare që të ketë një përcaktim të tillë, AK është e obliguar që të dërgojë kërkesë për sqarim të tenderit në bazë të nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe pikën 39.8 të Rregullës së Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Përgjigje në Pretendimin ankimor nr.4

AK ka konstatuar se mungon nënshkrimi dhe vula e OE-së në listën e detajuar të produkteve. Konstatimi i tillë është i bazuar, ngase një dokument i tillë është kërkuar shprehimisht si dëshmi dokumentare në Njoftimin për Kontratë dhe dosjen e tenderit. Pra, për të qenë valid ky dokument, OE është dashur të veprojë njëjtë si tek "Aneks 2 – Deklarata nën betim".

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e AK-së.

Autoriteti Kontraktues me datën 06.10.2020 me anë të parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik nuk e ka njoftuar OSHP-në se a pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "IT Market" sh.p.k – Prishtinë, se AK e ka eliminuar me konstatimin se projektet e OE nuk janë të natyrës së kontratës. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të listës së kontratave të paraqitura nga OE, kontratat janë të natyrës së njëjtë dhe janë brenda kodit të klasifikimit të fjalorit të përgjithshëm të prokurimit (FPP) që ka kërkuar AK. Ky kod në njoftimin për kontratë është 50000000-5 dhe si fushëveprim ka "Pajisjet për meremetim, mirëmbajtje dhe Instalim", gjë që nga lista e projekteve të dorëzuara nga OE, bazuar në kontrata, referenca dhe përshkrimet tjera, ky aktivitet i prokurimit ka natyrën e njëjtë. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues "IT Market" sh.p.k – Prishtinë, se AK ka konstatuar se nuk janë përcaktuar personat me ndonjë vendim apo marrëveshje të veçantë për pozitat: Menaxher i projektit dhe Ekspert i rrjetave kompjuterike.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se lidhur me ndonjë marrëveshje apo vendim të veçantë për Menaxherin e Projektit dhe Ekspertin e rrjetave kompjuterike, në njoftimin për kontratë nuk është kërkuar ndonjë dëshmi e tillë dokumentare specifike. Prandaj, AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 59 dhe 72 të LPP-së dhe pikën 39.8 të Rregullës së Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, ku AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit", nëse CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara dhe AK nuk mund të vendos.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues "IT Market" sh.p.k – Prishtinë, ku AK ka konstatuar se për pesë teknik të implementimit – Mungojnë CV-të për të gjithë tekniket e implementimit kopjet e diplomave dhe janë paraqitur vetëm katër kontrata pune për kohë të pacaktuar.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se lidhur me stafin OE ka paraqitur CV-të dhe dokumente përcjellëse të 10 anëtarëve të stafit. Prandaj, AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 59 dhe 72 të LPP-së dhe Rregullës së Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, ku AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit", nëse CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara dhe AK nuk mund të vendos. Pra, meqenëse nuk ka qenë e qartë për komisionin e vlerësimit të AK-së, funksioni i secilit nga stafi i

paraqitur në ofertën e OE, dhe nga AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk janë kërkuar dëshmi dokumentare që të ketë një përcaktim të tillë, AK është e obliguar që të dërgojë kërkesë për sqarim të tenderit në bazë të nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe pikën 39.8 të Rregullës së Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Kurse, sa i përket pretendimit të OE ankues "IT Market" sh.p.k – Prishtinë, se AK ka konstatuar se mungon nënshkrimi dhe vula e OE-së në listën e detajuar të produkteve. Paneli Shqyrtues sqaron se konstatimi i tillë është i bazuar, mirëpo AK ka mundur të kërkoj sqarime shtesë nga OE konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, konsideron se AK e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, për shkak se gjatë procesit të ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave është dashur të kërkoj sqarime shtesë. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe pastaj të bëjë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

Goran MILENKOVIĆ

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Kuvendi Komunal- Prizren;

1x1 OE "IT Market" sh.p.k– Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.